

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS-GOV.NET



10

VJET ME IPK-në

IPK mbrojtës i integritetit policor

Revistë e Inspektoratit Policor të Kosovës >> Nr. 6, Viti IV / 2016

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

Revistë e Inspektoratit Policor të Kosovës >> Nr. 6, Viti IV / 2016

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS.GOV.NET

10

VJET ME IPK-në

IPK mbrojtës i integritetit policor

info

zimp.ipk@rks-gov.net

Revista "Integriteti" është botim i Inspektoratit Policor të Kosovës

Divizioni për Marrëdhënie me Publikun dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Botues: Inspektorati Policor i Kosovës

Kryeredaktor:
Arbër BEKA

Bashkëpunëtorë:
Lulzim THAÇI
Shqiponje SOPI

Tel: +377 (0) 44 146 696
E-mail: arber.beka@rks-gov.net,
arberbeka@gmail.com, zimp.ipk@rks-gov.net

INTEGRITETI

4-5

Kryeshefi
Mehmeti
filloi
detyrën



PËRMBAJTJA

SIM

SMI - RRUGA DREJT
FUQIZIMIT TË
INTEGRITETIT
8-9

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
IPK MBAJTI TRYEZË TË
RRUMBULLAKËT ME
QYTETARËT NË FERIZAJ
10-11

IPK

IPK NË BASHKËPUNIM ME
OSBE-NË MBAJTI TRI TRYEZA
TË RRUMBULLAKËTA NË
MITROVICËN E VERIUT
15

FAKULTETI - AKSP

FAKULTETI I SIGURISË
PUBLIKE NË AKSP
SË SHPEJTI PRET
GJENERATËN E TRETË TË
STUDENTËVE
16-17

PROJEKTI I BINJAKËZIMIT

PROJEKTI I BINJAKËZIMIT PÛRKRAH
PROKURORINË, IPK-NË DHE PK-NË
ME NJË UDHËZUES
20-21

IPK DHE SHÇBA

IPK DHE SHÇBA NË
INSPEKTIM TË PËRBASHKËT
22-23

6-7

IPK
mbrojtës
i integritetit
policor



18-19

Perspektivat
e planifikimit
të integritetit



12-14

10 vjet nga
themelimi i
Inspektoratit
Policor të
Kosovës



PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet,
këndvështrimet e shprehura
ose të përfshira në përmbajtje
të këtij botimi nuk paraqesin
medeomos politikat ose
vështrimet zyrtare të IPK-së.

KRYESHEFI MEHMETI FILLOI DETYRËN



Kryeshefi Mehmeti pranon detyrën

Në objektin e Inspektoratit Policor të Kosovës u bë pranim-dorëzimi i detyrës nga ish Kryeshefi z. Fitim Shishani te Kryeshefi i IPK-së z. Hilmi Mehmeti.

Ceremonia e pranimit të detyrës u realizua në sallën e konferencave në prezencë e Zëvendës

ministrit të MPB-së z. Valdet Hoxha, përfaqësuesve nga ICITAP-i amerikan, EULEX-i dhe stafit menaxhues të Inspektoratit Policor.

Me këtë rast z. Fitim Shishani duke i uruar sukses Kryeshefit të IPK-së z. Hilmi Mehmeti i dorëzoi të njëjtit Planin Zhvillimor Strategjik 2016-2018

dhe “Projektin për regionalizimin dhe fuqizimin e IPK-së.

“Kolegu im Hilmi Mehmeti ka kapacitetet për të udhëhequr këtë institucion dhe ka një ekip të mirë në IPK që do ta ndihmojë në realizimin me sukses të detyrave” – theksoi z. Shishani duke falënderuar stafin menaxhues të IPK-së dhe partnerët ndërkombëtar ICITAP dhe EULEX.

Kryeshefi i IPK-së z. Hilmi Mehmeti me rastin e pranimit të detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së theksoi se do të vazhdoj angazhimet e tij profesionale drejt avancimit të punës së IPK-së:

“Do të vazhdoj të avancoj punën e Inspektoratit Policor drejt realizimit me sukses të misionit ligjor duke punuar si një ekip e përbashkët edhe drejt avancimit të punës së Policisë së Kosovës” – theksoi Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së z. Hilmi Mehmeti.

Edhe Zëvendës Ministri i MPB-së z. Valdet Hoxha duke falënderuar për punën e deritashme të Kryeshefit Shishani theksoi edhe njëherë se IPK do të vazhdoj të ketë përkrahjen nga MPB-ja:

“Në emër të Ministrisë të MPB-së dua të shpreh përkrahjen e plotë për pozitën e Kryeshefit dhe IPK-së dhe në këtë mënyrë do të arrijmë objektivat e Ministrisë së Brendshme që janë avancimi - sundimi i rendit dhe ligjit dhe sigurisë publike në Republikën e Kosovës” – theksoi z. Ministri Hoxha duke potencuar bindjen se përvojën që ka Kryeshefi nga policia do ta kombinoj



Sopjani i uron detyrën Mehmetit



Maxhuni i uron detyrën Mehmetit

me përvojën që kërkohet në IPK. Pas pranimit të detyrës Kryeshefi i IPK-së z. Hilmi Mehmeti priti në takim zyrtarë të lartë të agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve tjera të Republikës së Kosovës të cilët i uruan detyrën. Në një prej takimeve z. Mehmeti priti në zyrën e tij Drejtorin e Përgjithshëm

të PK-së z. Shpend Maxhuni i cili e uroi për detyrën e re dhe të dytë u zotuan për bashkëpunim të mëtutjeshëm dhe përkrahjen reciproke për të dy institucionet drejt avancimit të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës. Kryeshefi Mehmeti priti në takim edhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë z. Shkelzen

Sopjani. Ai shprehu mirënjohje për vizitën dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në të mirë të sigurisë së vendit duke u zotuar së bashku me z. Sopjani për bashkëpunim të mëtutjeshëm në shumë fusha të përbashkëta të dy agjencive të sigurisë duke përfshirë por pa u kufizuar në trajnime të përbashkëta, shkëmbim përvojash etj.



IPK MBROJTËS I INTEGRITETIT POLICOR

IPK vlerëson lart bashkëpunimin me ICITAP-in Amerikan i cili është i rëndësishë së veçantë dhe ka karakter shumë dimensional. Ky bashkëpunim, përveç natyrës këshillëdhënëse dhe mbështetëse, ka ndihmuar IPK-në edhe në ndërtimin e kapaciteteve . IPK ndër vite ka përfituar nga ICITAP-i trajnime konkrete nga fushat e nevojshme për ngritjen e cilësisë së punës në IPK dhe për të kryer mandatet dhe misionin e IPK-së me një kualitet të lartë.

Takimet e rregullta të menaxhmentit të IPK-së me përfaqësuesit e kësaj organizate, përkushtimi dhe puna e tyre e pa lodhshme, ka bërë që IPK-ja të njihet si organizatë e cila dëshmon para qytetarëve të saj dhe të tjerëve se është një organizatë e trajnuar mirë, e përgatitur për t'u ballafaquar me sfida, dhe objektive për të kërkuar të vërtetën gjatë ushtrimit të funksioneve të saj. Bazuar në këtë, në pjesën e profilit në revistën "Integriteti" po ju sjellim intervistën me znj. Drita Perezic – Këshilltare e lartë e ICITAP-it pranë menaxhmentit ekzekutiv të MPB-së.

Integriteti: Zonja Perezic, ICITAP nga IPK-ja njihet si një ndër partnerët strategjik që i ka ofruar përkrahje dhe këshillëdhënie në shumë fusha IPK-së. Jemi në prag të 10 vjetorit të IPK-së, që konsiderohet si një vite jubile për Inspektoratin, sa ka pasur zhvillime në Inspektoratin Policor të Kosovës, gjatë këtyre viteve sa kemi pasur bashkëpunim?

Drita Perezic - ICITAP: Unë për vete kam ardhur në vitin 2012, shumë pak kohe pasi që ju e keni marr mandatin e ri ose ju ka zgjeruar mandati të ndërmermi edhe hetime penale ndaj punonjësve të PK-së. Inspektorati prej themelimit i ka pasur disa sfida dhe të gjithë e dimë cilat



Drita Perezic – ICITAP

janë ato sfida dhe ia ka dalë përballë me sukses. Kur ka ardhur momenti i ndryshimit të kompetencave, janë ndërmarrë hapat e duhur: është profesionalizuar stafi në të gjitha nivelet e udhëheqjes të menaxhimit po edhe operativ, dhe e tërë kjo është pasqyruar edhe në raportet vjetore ku ju keni publikuar statistikën. Mund të them se zhvillimi i IPK-së prej pikënisjes e deri më sot është tepër serioz por duhet punuar që njerëzit të kuptojnë akoma më shumë për rolin dhe mandatin e IPK-së.

Integriteti: Ndërlidhur me përgjigjen e parë, kur thoni që duhet punuar akoma më shumë që njerëzit të dinë më shumë për rolin dhe mandatin e IPK-së, çfarë aktiviteteve do të duhej të ndërmerre IPK në mënyrë që të

zgjerohen njohuritë e qytetarëve apo zyrtarëve për IPK-në?


Drita Perezic - ICITAP: Më lejoni të them se IPK është duke bërë atë që duhet për të ngritur nivelin e sensibilizimit edhe brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë, si një audiencë e veçantë por edhe jashtë saj. Më duket që keni depërtuar mjaftë mirë duke lansuar projektin e Kutive të ankesave, Linjën e kaltër (numri pa pagesë i IPK-së), duke hapur zyrat rajonale, ju poashtu keni organizuar takime me qytetarë në komuna të ndryshme dhe keni lëshuar komunikata për media e kështu që mendoj se keni qenë shumë aktiv dhe se ashtu duhet edhe të vazhdoni. Unë nuk dyshoj që çdo qytetar në Kosovë nga të gjitha komunitetet është i njoftuar për mandatin e IPK-së dhe rrallë mund të hasësh

në ndonjë qytetar që nuk e din se kush është IPK-ja. Tani ndoshta me komunitetin serb në veri të vendit duhet pak më shumë punë në kuptimin e mirë të fjalës. Ndoshta do të mund të shqyrtoni mundësinë që herë pas here bashkë me trajnimet e ndryshme që mban policia të lansoni një lloj fushate vetdijësuse që do të ndërli dhej me zhvillimin profesional të policisë duke u fokusuar në njësi të caktuara apo nivele të ndryshme të menaxhimit duke vënë në pah se cili është mandati i IPK-së dhe pse është mirë që të përkrahet, si mund të bashkëpunohet me IPK-në etj.

Integriteti: IPK-së nuk i ka mundur përkrahja nga ICITAP-i edhe Ambasada Amerikane në Kosovë me trajnime të vazhdueshme, a do të vazhdoj përkrahja e ICITAP-it në këtë drejtim për stafin operativ të IPK-së?

Drita Perezic - ICITAP: Më lejoni së pari të them që ndjehem e nderuar dhe privilegjuar që kam bashkëpunuar dhe vazhdoj të bashkëpunoj me IPK-në. ICITAP-i e ka planifikuar që në fund të vitit 2015 të përfundoj projektin me IPK-në në mënyrën si ka ekzistuar deri më sot. Kjo nuk nënkupton tërheqje të tërësishme nga IPK-ja por të angazhohet me një këshilltar të veçantë, përmes takimeve etj. Por, e kemi pa të arsyeshme që ta vazhdojmë deri në fund të vitit 2016, dhe ne këtë e shohim si një tregues të suksesit të IPK-së që IPK nuk ka me nevojë për diçka të tillë. IPK tashmë e ka treguar funksionalizimin e vet që nuk ka më nevojë për një këshilltar të dedikuar vetëm për të. Ne do ta përkrahim IPK-në me trajnime të ndryshme të avancuara deri në fund të vitit 2016 si dhe në disa angazhime të tjera siç janë plotësim ndryshimi i ligjit për IPK-në etj.

Pas 2016-ës ICITAP normal që vazhdon me aktivitete të saj në kuadër të programit që është brenda MPB-së dhe në kuadër të kësaj do të ketë një mbështetje të veçantë për IPK-në, por prej nivelit të Ministrisë karshi obligimeve që ka



ministra drejt koordinimit të punëve të agjencive të saj.

Integriteti: E përmendet çështjen e ndryshimit të Ligjit për IPK-në, që ka hyrë në planin legjislativ të MPB-së, dhe shumë çështje tjera që ndërli dhej me zhvillimin e IPK-së në të ardhmen, si e shihni IPK-në pas disa viteve?

Drita Perezic - ICITAP: Unë IPK-në e shoh me të vërtet si një mjet të menaxhimit të riskut edhe të Policisë edhe të Ministrisë sa i përket inspektimeve të cilat luajnë një rol crucial në këtë drejtim. Ju nuk i bëni Inspektimet e vijës së parë pasi që ajo ndoshta është obligim i Policisë, por ju bëni inspektime që janë më sistematike dhe tërë sistemit dmth i procedurave të ndryshme në nivelin ose rajonal ose kombëtar. Përmes inspektimit ju i jepni policisë informata të duhura që së bashku edhe me profesionalizimin e tyre të vijën deri te vendimet më të mira drejt zhvillimit të policisë. Unë në këtë drejtim e shoh që do të arrihet një moment ku me të vërtet do të kuptohet kontributi i IPK-s nga menaxhmenti ekzekutiv i Policisë por edhe i MPB-së

Nga aspekti i hetimeve, unë e kam thënë se në asnjë shtet nuk pritet që mekanizmi i kontrollit të brendshëm të mirëpritët

për shkak të vet natyrës së saj, unë shpresoj që IPK do të kuptohet drejt si një mbrojtës i Integritetit të forcës policore, mbrojtësi i gjithë atyre policëve që me nder dhe me krenari e veshin uniformen dhe i kryejnë obligimet dhe detyrat e tyre me faqe të bardhë. Shpresoj që njerëzit edhe fillojnë të kuptojnë që IPK, megjithëse e kryen një punë të palakmueshme, ajo është një punë e duhur që është në shërbim të forcës policore dhe kur legjitimiteti dhe kredibiliteti i saj është në pyetje, Inspektorati është një ndër mjetet kryesore që është si një bazament i fortë që i del në mbrojtje.

Integriteti: Çfarë porosie kishit bart për lexuesit e revistës Integriteti po edhe për punonjësit e IPK-së,?

Drita Perezic - ICITAP: Punonjësvetë të IPK-së u kisha thënë vetëm vazhdoni në këtë rrugë që keni filluar, pasi që nuk ka nevojë asnjë ndryshim të nivelit të përkushtimit, të seriozitetit, dhe profesionalizmit me të cilin e merrni obligimin që e keni si pjesëtarë të IPK-së. Për lexuesit shpresoj që në çdo numër të "Integritetit" veç gëzohen dhe frymëzohen edhe më shumë me një institucion që me të vërtet e meriton ky shtet, e meriton ky popull, e meriton kjo polici, e meriton kjo Ministri.



SMI

RRUGA DREJT FUQIZIMIT TË INTEGRITETIT

Kjo rrugë drejt rezultateve të tilla ishte shumë e vështirë, plot me pengesa, por u udhëhoq nga një vullnet i fortë nga këto agjenci

Të gjitha hulumtimet në mbarë Kosovën treguan se agjencitë e zbatimit të ligjit kanë një reputacion shumë të lartë brenda shoqërisë.

Kjo rrugë drejt rezultateve të tilla ishte shumë e vështirë, plot me pengesa, por u udhëhoq nga një vullnet i fortë nga këto agjenci.

Të gjitha vendet duhet të përballen me mos funksionim adekuat të

institucioneve qeveritare, të cilat mund të jenë sjellje pahijshëm apo që është më e keqja të jenë të korruptuar.

Qeveria ka ndërtuar struktura të qëndrueshme organizative që vlerësojnë veten, si dhe paralelisht ka themeluar edhe mekanizma të kontrollit të jashtëm, si Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Inspektoratin Policor të Kosovës.



Të gjitha hulumtimet në mbarë Kosovën treguan se agjencitë e zbatimit të ligjit kanë një reputacion shumë të lartë brenda shoqërisë

Përveç kësaj, ka kritika edhe nga institucionet ndërkombëtare apo organizatat jo-qeveritare vendore ndaj agjencive për zbatimin e ligjit.

Ekzistojnë edhe dokumentet ligjore dhe të politikave që rregullojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm të punës së policisë. Megjithatë, progresi i mëtejshëm është i nevojshëm për të forcuar politikën e integritetit dhe të definojë atë edhe më mirë. Subjekteve të lartpërmendura u mungon një plan gjithëpërfshirës për integritet lidhur me përditshmërinë e zbatimit të ligjit dhe tani “ka rënë zilha” që të gjitha organizatat duhet të ketë një plan të tillë veprimi i cili mbështet menaxhmentin për të rritur integritetin.

Të gjitha përkufizimet e integritetit përmbajnë dy elemente. E para është ajo që është e drejtë: vlerat etike, parimet morale, mençuria. E dyta është ajo që ju bëni: veprimet dhe sjellja juaj. Integriteti është të keni forcë të brendshme personale dhe kurajën që gjithmonë ti ndërlidhni të dyja, madje edhe në situata të vështira, madje edhe kur ju nuk merrni asnjë avantazh nga kjo apo edhe rrezikoni që të jeni në disavantazh prej saj, edhe kur të tjerët duan apo presin që ju të silleni ndryshe: drejtoje sjelljen tuaj me vlerat etike, bëni atë që është e drejtë.

Një lajm i mirë është se jo vetëm planin e integritetit, por i tërë Sistemi i Menaxhimit të Integritetit (SMI) është themeluar me kërkesën e qeverisë nëpërmjet Projekti të Binjakëzimit në dy vitet e fundit.

Në vitin 2014 filloi projekti me një kërkesë të qartë: të japë këshilla për menaxhmentin e Policisë së Kosovës dhe drejtësisë për të krijuar një mekanizëm efektiv të brendshëm mbikëqyrës kundër

sjelljes së keqe dhe korrupsionit.

Një grup ekspertësh të Hungarisë të mbështetur nga homologët vendorë filluan të grumbullojnë informacione në lidhje me mjetet ekzistuese të integritetit nga projektet apo iniciativat e mëparshme të cilat mund të mbështesin procesin.

Duke përdorur Pakon e instrumenteve mbi integritetin e policisë të DCAF-it dhe analizimin e praktikave më të mira në Hungari dhe në të gjithë Evropën, ekspertët dizajnuan një sistem të veçantë për Policinë e Kosovës.



Sistemi ka shtyllat e ndryshme duke përfshirë në radhë të parë mjetet ligjore të cilat tashmë ekzistojnë dhe duke caktuar kufij të qartë për të punësuarit. Sistemi i propozuar përbëhet nga tre shtylla të cilat mbulojnë instrumentet për integritetin, si parimet, politikat, planet dhe procedurat. Pjesa e dytë e dytë e sistemit është procesi i vazhdueshëm i ruajtjes dhe mbrojtjes së integritetit në kuadër të Policisë së Kosovës, që do të thotë një task grup i zyrtarëve që janë këshilltarë - analistë - monitorues - kontrollues. Ky proces do të sigurojë përparim drejt përcjelljes së trendeve të korrupsionit dhe sjelljeve të këqija, duke e lëvizur Policinë e Kosovës një hap përpara rrezeve.

Nga ana tjetër është një proces i vazhdueshëm i vlerësimit i cili mbledh informacion në lidhje me kushtet e organizatës nga të gjithë punonjësit.

Duke u bazuar në këto informata krijohet hapësira për të krijuar një Plan Integriteti i cili synon për të rregulluar të gjitha këto probleme të ngritura gjatë periudhës së provimit, dhe mund të mbush boshllëqet dhe dobësitë e strukturës dhe rrjedhën e punës. Në këtë plan të gjithë akterët mund të gjejnë detyrat e tyre të sakta me “modus operandi” dhe afate kohore.

Nëse organizata realizon të gjitha detyrat që dalin nga Plani i Integritetit, fillojnë veprimtaritë e modifikuara dhe pastaj vijon periudha e pyetësorëve.

I tërë cikli kryhet brenda një viti kështu që mund të bëhen vlerësime vjetore, dhe operatorët e sistemit janë të ashtuquajturit oficerët e integritet.

Në të njëjtën kohë oficerët që janë të emëruar si zyrtarë të integritetit mund të mbështesin kolegët e tyre se si të trajtojnë dilemat etike apo morale.

Nëse dikush ka njohuri për sistemin e menaxhimit të cilësisë mund të kuptojë se kjo është zgjidhje e përafërt me te.

Natyrisht për të vënë në funksion sistemin duhet të ketë disa veprime. Pra, propozimi përmban një fushatë të brendshme mediale me fletushka, posterë dhe video-spote, artikuj dhe faqe në Intranet ku të gjithë ata që duan të dinë më shumë mund të gjejnë përgjigje.

Gjatë projektit ekspertët kanë ofruar pesë trajnime në lidhje me analizën, vetëdijesimin për integritetin, strukturën e Sistemit të Menaxhimit të Integritetit. Përfitues kanë qenë Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës dhe Prokuroria.

Laszlo Elek

IPK MBAJTI TRYEZË ME QYTETARË



Inspektorati Policor i Kosovës, në bashkëpunim me ICITAP –in, Divizionin për siguri në bashkësi të MPB-së, Policinë e Kosovës dhe EVSB-të (Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi), ka planifikuar dhe realizuar organizimin e disa aktiviteteve (tryezave

të rumbullakëta) nëpër Komunitet e Kosovës. Me përkrahjen e Kuvendit Komunal të Ferizajt një aktivitet i tillë u mbajt në Ferizaj me titullin “Inspektorati Policor i Kosovës, roli dhe rëndësia në sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës”. Lidhur me rëndësinë e këtij

aktiviteti dhe rolin e Inspektoratit Policor të Kosovës në sundimin të ligjit në Kosovë gjatë fjalëve të rastit folën Kryetari i Kuvendit Komunal z. Muharrem Svarqa, Zëvendës ministri i MPB-së z. Nehat Mustafa dhe përfaqësuesja e ICITAP-it amerikan znj. Drita Perezic. Në këtë



TË RRUMBULLAKËT ET NË FERIZAJ

Inspektorati Policor i Kosovës, në bashkëpunim me ICITAP -in, Divizionin për siguri në bashkësi të MPB-së, Policinë e Kosovës dhe EVSB-të (Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi), ka planifikuar dhe realizuar organizimin e disa aktiviteteve (tryezave të rrumbullakëta) nëpër Komunat e Kosovës



aktivitet zyrtarë të Inspektoratit Policor të Kosovës prezantuan informacione lidhur me fushëveprimin e IPK-së duke u përgjigjur edhe në pyetjet e qytetarëve prezent.

Zyrtarët e IPK-së para qytetarëve ferizajas theksuan se “prezenca e IPK-së afër qytetarëve do të thotë mbështetje për realizimin e të drejtave të tyre, ndërsa prezenca e IPK-së, afër policisë do të thotë përkrahje për fuqizimin e integritetit dhe rritjen e kredibilitetit

të Policisë së Kosovës”. Organizimi i aktiviteteve të tilla ka për qëllim që Inspektorati Policor i Kosovës, të jetë më afër qytetarëve të Kosovës duke ofruar informacione për fushë-veprimtarinë e IPK-së dhe projektet e iniciuara si “Hapja e Zyrave Rajonale të IPK-së”, “Kutia e Ankesave” dhe “Linja e kaltër” (linja pa pagesë për qytetarët përmes numrit 080003333).

Aktivitete të tilla pritet të organizohen edhe në komunat e tjera.





Gjenerata e parë e Inspektorëve të IPK-së së bashku me Ekipin Zbatues të themelimit të IPK-së nga OSBE në vitin 2006

10 VJET NGA THEMELIMI I INSPEKTORATIT POLICOR TË KOSOVËS

Ishte viti 1999 kur lufta e qytetarëve të Kosovës për pavarësi përfundoi dhe Kosova ishte e lirë duke kaluar në protektorat ndërkombëtar nën administrimin e misionit të Kombëve të Bashkuara në Kosovë- UNMIK.

Si një vend i posa dalë nga lufta, qytetarët e Kosovës në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, si qëllim parësor kishin rindërtimin e Kosovës duke përfshirë edhe ngritjen e institucioneve të saj vet-qeverisëse.

Një ndër institucionet e para që ishin

themeluar ishte edhe Policia e Kosovës (atëherë Shërbimi Policor i Kosovës) që u krijua me 06/09/1999 e cila filloi të rekrutojë dhe trajnoj gjeneratat e para të zyrtarëve policorë sipas koncepteve demokratike të policimit.

Në vitin 2005-2006 nga PSSP (Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm) të OKB-së kishte lëshuar rregullore të veçanta për të hapur rrugën për të themeluar Inspektoratin Policor të Kosovës si një mekanizëm mbikëqyrës i policisë, i pavarur nga Policia e

Kosovës.

Korniza ligjore për Inspektoratin Policor të Kosovës përbëhej prej Rregullores 2005/54, nenit 9 (mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës) dhe Urdhërësës Administrative 2006/9 ,Shtojca A ku thuhej;

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të themelojë Inspektoratin Policor të Kosovës për:

a) Kryerja e auditimeve dhe inspektimeve të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të raportojë për performancën e saj dhe

**Ishte viti 1999 kur
lufta e qytetarëve të
Kosovës për pavarësi
përfundoi dhe Kosova
ishte e lirë duke
kaluar në protektorat
ndërkombëtar nën
administrimin e
misionit të Kombëve të
Bashkuara në Kosovë-
UNMIK**

efikasitetin në arritjen e objektivave;
dhe

b) Hetojë akuzat se policët ose anëtarët civilë të Shërbimit Policor të Kosovës kanë kryer shkelje të rënda disiplinore, dhe të rekomandojë për Këshillin për Emërime të Larta Policore dhe Disiplinë (KELPD), nëse ka sanksion disiplinor që duhet të imponohen.

Inspektorati Policor i Kosovës parashihej të themelohej si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ishte paraparë të ishte i pavarur nga Shërbimi Policor i Kosovës dhe personeli i saj dhe burimet materiale nuk do të konsideroheshin si personel dhe burime materiale të Shërbimit Policor të Kosovës; IPK do të veprojë në mënyrë profesionale dhe të paanshme, duke respektuar plotësisht standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të lirë nga ndërhyrjet e panevojshme politike, dhe në interes të të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Në shtator të vitit 2005, ishte bërë një marrëveshje ndërmjet Shefit të Shtyllës së I-rë të UNMIK-ut dhe ambasadori i OSBE , Z. Werner Wnendt për themelimin e IPK-së. Një ekip i vogël i stafit të OSBE-së ishte nxjerr nga

Departamenti i Arsimit dhe Zhvillimit të Policisë (DZHEP) dhe kishte formuar Ekipin Zbatues për themelimin e IPK-së.

Që në fillim Ministria e Punëve të Brendshme, e sapo themeluar, kishte autoritet të plotë ekzekutiv për IPK-në, ndërsa OSBE-ja ofronte një gamë të gjerë të masave mbështetëse për të lejuar këtij institucioni të ri të fillojë punën sa më shpejt.

Përdërisa ndërtimi i kapaciteteve do të formojë thelbin e kësaj përpjekjeje, Ekipi Zbatues i IPK-së kishte përgatitur buxhetin e vitit 2006 ndërsa stafi i Ministrisë të MPB-së kishte ushtruar autoritetin ekzekutiv në lidhje me përzgjedhjen e stafit për IPK, blerjen e automjeteve , pajisjet për zyre dhe një



ndërtesë me qira. Po ashtu, s t r u k t u r a organizative e IPK- së, përshkrimet e punës , Procedurat Standarde Operative dhe dokumente të tjera të përgatitura nga ana e OSBE-së dhe janë përdorur vetëm pasi ato janë miratuar nga Ministri i MPB-së.

Pjesa më e madhe e përpjekjeve të OSBE-së ishte fokusuar në hartimin dhe zhvillimin e një programi të plotë për ndërtimin e kapaciteteve në dy faza. Ai ishte vendosur për të ndarë IPK- në dy grupe, secila me funksione

të specializuara që përgjigjej për rolet proaktive dhe reaktive , siç përcaktohet në Rregulloren 2005/54 dhe Urdhresës Administrative 2006/9 .

Duke ditur se pa besim dhe bashkëpunim aktiv të personelit të SHPK-së dhe IPK-së nuk mund të kishte shpresë për sukses, Ekipi i Zbatimit kishte hartuar një program që shumë shpejt të zhvillohej dhe të ruhej një marrëdhënie efektive pune me SHPK-në. Prandaj, ishte vendosur për të zgjedhur dhe për të trajnuar stafin e IPK-së në dy faza.

Zhvillimi dhe zbatimi i një kuadri të shëndoshë ligjor për Inspektoratin Policor të Kosovës, ishte padyshim i rëndësishëm për suksesin e saj.

Në fazën e parë, ekipi i IPK-së do të trajnohen në funksion proaktive dhe, pasi kjo të ishte kryer me sukses, një grup i dytë do të rekrutohej dhe trajnohej në funksion reaktive.

Në fazën e parë u rekrutuan fillimisht 20 inspektor që u trajnuan në funksionin proaktiv. Me këtë qasje synohej ndërtimi i besimit te stafit të IPK-së tek të inspektuarit- Policia, përmes punës më pak konfrontuese siq ishte inspektimi, si dhe të lejojë që ata të zhvillojnë njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e organizatës së SHPK-së. Në fazën e dytë u rekrutuan edhe 20 hetues që u trajnuan në funksionin reaktiv të cilët do të merren me ankesat kundër policëve që mund të vënë në dyshim besueshmërinë e hetuesve në një hetim disiplinor.

Bazuar në qasjen e “të mësuarit-aktiv” për arsimimin e të rriturve, programi ndërtimi i kapaciteteve të OSBE-së kishte projektuar për të operacionalizuar IPK brenda disa javësh. Kështu, në fazën e parë të programit gjashtë muajsh, zyrtarët e IPK-së kanë alternuar midis periudhave të punës në klasë dhe punës në terren operacional. Në mënyrë tipike, rekrutët e rinj do të kalojnë një javë në klasë duke studiuar aftësitë e raportimit me shkrim, të ligjeve të zbatueshme dhe të teorisë dhe praktikës menaxheriale,



Gjenerata e parë e Inspektorëve të IPK-së gjatë trajnimit intensiv gjashtë mujor nga OSBE gjatë vitit 2006

duke ndjekur parimin nga të mësuarit e thjeshtë në të mësuarit kompleks.

Në të gjitha këto fusha kryesore janë përcjell me vlerësime individuale, testime me shkrim në kurset e rregullta dhe provime formale. Të trajnuarit e IPK-së janë monitoruar nga afër nga stafi i OSBE-së, për të siguruar se punët janë kryer në përputhje me ligjin dhe kanë demonstruar integritetin, profesionalizëm dhe qëndrimet të tjera thelbësore të IPK-së.

Në vitin 2008 Kosova finalizon vullnetin e përhershëm të qytetarëve të saj duke shpallur pavarësinë dhe duke miratuar kushtetutën e saj si një shtet i pavarur demokratik me një sistem parlamentar të qeverisjes dhe duke zëvendësuar rregulloret e UNMIK-ut me ligje të nxjerra nga përfaqësuesit e popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Një ndër këto ligje ishte edhe ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Ky ligj kishte pothuajse të njëjten përmbajtje sikurse edhe rregullorja e UNMIK-ut me disa ndryshime të cilat fuqizonin IPK-në si një mekanizëm i jashtëm i mbikëqyrjes policore i pavarur nga Policia e Kosovës e cila kishte mandat inspektimin e strukturave policore dhe hetimin disiplinor të shkeljeve të lehta dhe të rënda të pjesëtareve të tyre ku kishte një këshill të lartë për disiplinë policore i cili ishte i përbërë nga shërbyes civil nga administrata shtetërore të cilat i gjykonin rastet e shkeljeve disiplinore të policëve të hetuara nga IPK-ja.

Kjo fazë përbën edhe kohën e zhvillimit profesional të IPK-së në aspektin e përvojës në drejtim të pjekurisë institucionale përmes mandateve të

saj duke u përkujdesur që Policia e Kosovës kryen detyrat dhe përgjegjësitë e saj konform Kodit Evropian të Etikës Policore.

Në vitin 2010, IPK pas një analize të punës dhe mandateve të saj, kishte ardhur në përfundim se hetimi i vetëm shkeljeve disiplinore të policëve pa përfshirë edhe ato penale, të cilat deri në atë kohe ishin ende në mandatin e Policisë së Kosovës që të hetonin vetveten në aspektin penal, nuk ishte e mjaftueshme. Prandaj, me përkrahjen MPB-së e edhe të partnerëve ndërkombëtare siç ishte ICITAP (Departamenti i Drejtësisë, Ambasada e SHBA-së Kosovë), OSBE, EULEX, EU etj, u vendos që ligji për IPK-në të rishikohet dhe të amendamentohet.

Qëllimi kryesor i këtij rishikimi ishte në atë që IPK të merrte edhe mandatin shtesë që të hetonte edhe shkeljet e punonjësve të Policisë që përbënin vepër penale me Kodin Penal të Kosovës si dhe personeli operativ i IPK-së të ketë autorizime policore.

Në dhjetor të vitit 2010 pas miratimit në Kuvendin e Kosovës ky ligj hyri në fuqi duke i dhënë IPK-së mandatin për hetime penale ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës.

Gjatë viteve 2010-2015, IPK kishte hyrë në fazën e pjekurisë së plotë duke nxjerr të gjitha aktet nënligjore përcjellëse të ligjit të ri, duke hartuar planin e saj zhvillimor strategjik, duke dyfishuar numrin e personelit të saj operativ, duke punuar në mënyrë intensive për ngritjen e vizibilitetit të organizatës tek qytetarët përmes një komunikimi proaktiv përmes komunikatave, ligjëratave, konferencave, video dhe radio spoteve, duke ofruar shërbimet më afër qytetarëve përmes numrit falas të telefonit, kontaktit përmes internetit, iniciativës së hapjes së zyrave regionale.

Trajnimet e shpeshta të ofruara nga ICITAP në fusha e hetimeve të avancuara penale dhe në inspektime nga agjencitë më të njohura botërore të zbatimit të ligjit siç ishin Departamenti i Policisë së Los Anxhelos, Universiteti Northwest, prokuror të ndryshëm federal nga SHBA, Marina Amerikane etj. Të gjitha këto trajnime të ofruara nga ICITAP kishin bërë që profesionalizmi në IPK, sa i përket mandateve hetimore dhe inspektuese të jenë të standardeve më të larta.

IPK sot është pjesë e shumë nismave dhe organizatave ndërkombëtare të mbikëqyrjes policore siç është EPAC si dhe përfaqëson Kosovën në të gjitha nismat ndërkombëtare dhe rajonale lidhur me mekanizmat mbikëqyrës të policisë si shembull suksesi edhe për të tjerët.





IPK NË BASHKËPUNIM ME OSBE-në MBAJTI TRI TRYEZA TË RRUMBULLAKËTA NË MITROVICËN E VERIUT



Inspektorati Policor i Kosovës në organizimin dhe bashkëpunimin me OSBE mbajti tryeza të rrumbullakëta me zyrtarët policorë të stacioneve policore të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës në Mitrovicën e Veriut duke përfshirë stacionin policor Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe atë të Mitrovicës së Veriut.

Ky aktivitet që u mbajt në Mitrovicën e Veriut dhe Zveçan kishte për synim diskutimet e hapura për fushëveprimin e IPK-së (rolin dhe autorizimet), shpjegimet për ecurinë e procedurës hetimore në rastet që trajton IPK në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, procedura disiplinore dhe ecuria e saj, të drejtat e punonjësve të PK-së në rastet e hetimit të brendshëm dhe aktivitetet tjera të IPK-së drejt fuqizimit të integritetit të Policisë së Kosovës.

Përfaqësuesit nga IPK-ja në këto takime – tryeza të rrumbullakëta dhanë shpjegime për zyrtarët policorë lidhur me rolin e IPK-së, autorizimet ligjore dhe hapjen e zyrës rajonale të IPK-së në Mitrovicën e Veriut.

Pjesëmarrës në këto tryeza të rrumbullakëta ishte edhe Kryeprokurori i Prokurorisë në Mitrovicë z. Shyqyri Sylja dhe përfaqësues të Drejtorisë së Standardeve Profesionale të PK-së.





Lutfi Ukiqi



Zijeve Keqmezi



Xhemajl Rexhepi

FAKULTETI I SIGURISË PUBLIKE SË SHPEJTI PRET GJENERATËN E TRETË TË



Mbi 100 pjesëtarë të agjencive të sigurisë publike janë duke vazhduar studimet në vitin e parë dhe të dytë akademik në programin studimor Bachelor në fushën e sigurisë në Fakultetin e Sigurisë Publike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Hapja e këtij Fakulteti është bërë me qëllim të avancimit të punës profesionale në të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe shënon një etapë të re me qëllim të avancimit profesional, i cili do të ndikojë në mënyrë pozitive në punën e pjesëtarëve të sigurisë publike. Studentët e gjeneratës së parë të fakultetit

e shohin veten të privilegjuar duke potencuar se nxënia e dijes aty do ndihmojë në zhvillimin e tyre profesional dhe në karrierë.

“Jam i kënaqur me kushtet dhe ligjëratat në fakultet, mendoj se studimet në këtë fakultet do të më ndihmojnë shumë në zhvillimin tim personal, në aspektin në fushën e sigurisë publike” – thekson togeri Lutfi Ukiqi, student në këtë fakultet.

Fakulteti ka hapur dyert për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve nga disa agjenci si: Inspektoratit Policor të Kosovës, Policisë së Kosovës, pastaj Doganës së

Kosovës, Shërbimit Korrektues, Menaxhimit të Emergjencave dhe Shërbimit Sprovues.


Edhe zyrtarja nga Dogana e Kosovës znj. Zijeve Keqmezi beson se ndjekja e ligjëratave në këtë fakultet do të ndikoj shumë në zhvillimin e saj profesional:

“Arsyeja pse unë kam aplikuar që të vijoj studimet këtu është zhvillimi i mëtutjeshëm profesional dhe pas përfundimit të gjitha njohuritë e fituara do ti përcjell në agjencinë ku punoj - Doganën e Kosovës” – theksoi Keqmezi.

Pjesë e gjeneratës së parë janë edhe dy zyrtarë të Inspektoratit Policor të Kos-

E NË AKSP STUDENTËVE

“Ne pretendojmë që pas katër viteve të jemi të aftë që kjo akademi të jetë rajonale pra edhe për vendet e rajonit, sepse në fund të fundit është edhe mision i themelimit të kësaj akademie përkatësisht të këtij fakulteti” – Nazmi Iballi – Dekan i Fakultetit të Sigurisë Publike në AKSP



ovës. Xhemail Rexhepi, hetues në Departamentin e hetimeve në IPK në një prononcim për revistën “Integriteti” thotë se pavarësisht praktikës dhe përvojës shumë vjeçare, studimet në këtë fakultet do ta ndihmojnë atë në profesionalizmin e mëtutjeshëm:

“Personalisht kam një kohë të gjatë që punoj në agjencitë e sigurisë publike e tani në Inspektoratin Policor të Kosovës, dëshira ime ka qenë që në mënyrë profesionale të përgatitem më shumë duke marrë parasysh që vetëm puna praktike nuk mjafton për zhvillimin e karrierës. Shpresoj se njohuritë që do të marr këtu t’i përdor drejt ngritjes së kualitetit të shërbimeve për qytetarët e vendit” – theksoi Rexhepi.

hapjen e fakultetit:

“Sfidat janë lidhur fillimisht me plan-programe me zbatimin e projektit të binjakëzimit, në kuptimin e kontakteve me ekspertët e akreditimit. Ne kemi prezantuar plan-programin përkatësisht kemi mbrojtur atë, një prej sfidave fillestare ka qenë kjo, mendoj se mirë kemi mbrojtur në kuptimin e asaj se si program ka qenë i ri për Kosovën. Programi është dashur të jetë kompatibil me kërkesat dhe zhvillimin, që në kuptimin e sigurisë për të ardhmen të kemi kuadro nga fakulteti i nivelit tillë që të perceptojnë realisht zhvillimet e sigurisë dhe avancimit të kësaj lëmie”- thekson z. Iballi.

Ai shpreson se në të ardhmen e afërt

Por përgatitjet deri në hapjen e fakultetit nuk kanë kaluar pa sfida. Dekani i fakultetit z. Nazmi Iballi në një prononcim për revistën “Integriteti” e përshkruan rrugëtimin deri në fillimin e studimeve dhe

fakulteti do të bëhet edhe me objektin e vet.

“Pa ndërtimin e objektit në njëfarë forme kufizohet puna jonë, pavarësisht që kampusi ofron kushte për momentin ideale në kuptimin e zhvillimit të mësimdhënies dhe mësim-nxënies për këtë nivel. Ne jemi duke punuar të gjithë së bashku në drejtim të sigurimit të objektit të fakultetit për të cilën kam informata se komuna e Vushtrrisë ka ndarë një parcelë për ndërtimin e objektit”.

Dekani së bashku me stafin tjetër mbështetës dhe përkrahjen e Drejtorit të Akademisë janë të angazhuar që programi i studimit të mos mbetet vetëm në nivelin bachelor por të avancohet edhe në nivelin master duke ofruar mundësi studimi jo vetëm për shtetasit e Kosovës por gradualisht të kthehet në një qendër rajonale.

“Ne pretendojmë që pas katër viteve të jemi të aftë që kjo akademi të jetë rajonale pra edhe për vendet e rajonit, sepse në fund të fundit është edhe mision i themelimit të kësaj akademie përkatësisht të këtij fakulteti” – theksoi z. Iballi duke falënderuar të gjithë ata që dhanë përkrahjen e tyre që Fakulteti i Sigurisë Publike të filloj me sukses punën.

Ky fakultet në AKSP është drejt përgatitjeve që së së shpejti të pranojë gjeneratën e tretë të studentëve nga agjencitë e sigurisë publike të Kosovës.



PERSPJEKTIVA E PLANIFIKIMIT TË INTEC

Inciuar nga Qendra e Gjenezës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), mbajtën seminarin për të diskutuar “Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Perspektivat e Planifikimit të Integritetit”, me akterët vendor dhe ndërkombëtarë.

Në këtë tryezë morën pjesë ministri i Punëve të Brendshme, ambasadorja e Zvicrës në Kosovë, znj. Krystyna Marty Lang, përfaqësues nga IPK-ja, përfaqësues nga PK-ja, anëtarët e Komisionit për Siguri, përfaqësues të shoqërisë civile dhe njohës të çështjeve të Sigurisë etj.

Ministri i Punëve të Brendshme, z.

DCAF dhe IPK mbajtën tryezën për “Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Perspektivat e Planifikimit të Integritetit”

Skënder Hyseni, me këtë rast falënderoi qeverinë zvicerane për mbështetjen e pa kursyer që ka dhënë institucioneve të sigurisë në Kosovë në ngritjen e kapaciteteve, theks të veçantë i ka vënë në përkrahjen për Kosovën në institucione që kryesisht kanë të bëjnë me mbikëqyrjen, kontrollin e performancës profesionale të institucioneve të rendit dhe ligjit. “Kontrolli demokratik, përkatësisht mbikëqyrja e institucioneve të rendit dhe ligjit është thelbësore, është kurciale dhe vendimtare për mirëmbajtjen dhe performancën e këtyre institucioneve. Po ashtu resurset njerëzore, kanë peshë të veçantë në ruajtjen e vazhdimësisë të kujtesës institucionale tek institucionet e rendit dhe ligjit”, tha ministri Hyseni.



AT GRITETIT

Ndërsa Ambasadorja e Zvicres në Kosovë, znj. Krystyna Marty Lang, tha se të ndërtosh një organizatë policore nuk është procedurë e lehtë. Policia e Kosovës është një organizatë e respektuar dhe e cila i përfaqëson ambiciet e Kosovës në respektim të diversiteteve të saj. Ambasadorja zvicerane theksoi se Kosova ka mekanizmat e duhura për të mundësuar punë të suksesshme për të luftuar korrupsionin dhe tha se këto diskutime do t’iu ndihmojnë të zhvilloni forma operative në mënyrë që Policia e Kosovës të ndihmohet në ngritjen e integritetit.

“Kjo tryezë do t’iu ndihmojë që të bëni planifikimet për integritetin dhe kjo nënkupton krijimin e një kornize ven-

dimarrëse për të identifikuar dhe analizuar dhe adresuar gjithçka në polici në një adresim të veçantë”, tha ambasadorja Lang. Në këtë tryezë folën edhe përfaqë-

sues të DCAF-it, Inspektoratit Policor të Kosovës, deputetë të Kuvendit të Kosovës, zyrtarë institucional dhe përfaqësues të shoqërisë civile.



Projekti i Binjakëzimit përkrah Prokurorisë, IPK-në dhe PK-në me një udhëzues

Ky udhëzues është zhvilluar në kuadër të projektit “Fuqizimi i kapaciteteve për hetim penal të krimit të organizuar dhe korrupsionit” dhe bazohet në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet përfaqësuesve të Prokurorisë së Shtetit në Kosovë, Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës

Ky udhëzues është zhvilluar në kuadër të projektit “Fuqizimi i kapaciteteve për hetim penal të krimit të organizuar dhe korrupsionit” dhe bazohet në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet përfaqësuesve të Prokurorisë së Shtetit në Kosovë, Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës.

Udhëzuesi me titull “Fuqizimi i bashkëpunimit në mes të Prokurorisë, Policisë dhe Inspektoratit Policor të Kosovës”, para së gjithash është dizajnuar për prokurorët e shtetit dhe hetuesit e IPK-së dhe PK-së, megjithëse segmente të caktuara brenda tij mund të shërbejnë si mjet i dobishëm edhe për agjencitë tjera të zbatimit të ligjit, institucionet dhe individët të cilët merren me zbatimin e ligjit në Kosovë, si dhe për universitetet kosovare për studime në fushat që kanë të bëjnë

me drejtësinë.

Këto udhëzime me siguri do të shërbejnë si mjet, i cili mund të jetë i dobishëm në masë të madhe për prokurorët e shtetit dhe hetuesit, pasi që bazohen në përvojat e ekspertëve në fushën e krimeve të rënda dhe në standardet bashkëkohore të shteteve të Bashkimit Evropian për zbulimin dhe hetimin efikas të veprave penale.

Sado që Kodi i Procedurës Penale përcakton procedurat paraprake dhe penale, ky udhëzues dhe shtojcat e bashkëngjitura janë krijuar me qëllim që përdoruesve t'i ofrojë prezantim gjithëpërfshirës dhe të saktë si dhe shpjegime mbi disa nga hapat e procedurave paraprake dhe penale.


Ky udhëzues pritet të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit dhe Prokurorisë, me qëllim të parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjen penale të krimeve të rënda.

Përmes adaptimit dhe implementimit të këtij udhëzuesi, palët synojnë të arrijnë objektivat në vijim:

- Përmirësimi i kapaciteteve të Policisë së Kosovës, Inspektoratit Policor të Kosovës dhe prokurorëve specialë në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Krijimi i regjistrit të hetimeve të suksesshme dhe ndjekjeve të krimeve të rënda;
- Forcimi i mekanizmi të brendshëm



Projekti i Binjakëzimit “Fuqizimi i Kapaciteteve për Hetim Penal të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit” është projekt i financuar nga BE-ja, menaxhuar nga zyra e Bashkimi Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Gjermania dhe Hungaria.



mbikëqyrës në Policinë e Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit;

- Ngritja e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, duke përfshirë ekipet hetimore dhe operacionet e përbashkëta;
- Rritja e ndërgjegjësimit publik duke përmirësuar cilësinë e informacionit të

dhënë për publikun dhe mediat etj.

Projekti i Binjakzimit "Fuqizimi i Kapaciteteve për Hetim Penal të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit" është projekt i financuar nga BE-ja, menaxhuar nga zyra e Bashkimi Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Gjermania dhe Hungaria.

Ky udhëzues pritet të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit dhe Prokurorisë, me qëllim të parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjen penale të krimeve të rënda

Përmes adaptimit dhe implementimit të këtij udhëzuesi, palët synojnë të arrijnë objektivat në vijim:

- Përmirësimi i kapaciteteve të Policisë së Kosovës, Inspektoratit Policor të Kosovës dhe prokurorëve specialë në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Krijimi i regjistrit të hetimeve të suksesshme dhe ndjekjeve të krimeve të rënda;
- Forcimi i mekanizmi të brendshëm mbikëqyrës në Policinë e Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Ngritja e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, duke përfshirë ekipet hetimore dhe operacionet e përbashkëta;
- Rritja e ndërgjegjësimit publik duke përmirësuar cilësinë e informacionit të dhënë për publikun dhe mediat etj.



IPK DHE SH

NË INSPEKTIM TË PËR

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe Shërbimi për Çështje të Brendshme dhe Ankesa (SHÇBA) inspektuan policitë kufitare të Kosovës dhe Shqipërisë

Në fund të muajit prill, në objektin

e Drejtorisë së Policisë në Kukës (Republika e Shqipërisë) pas një takimi të përbashkët në mes agjencive mbikëqyrëse të policisë së Kosovës dhe Shqipërisë (IPK-së dhe SHÇBA-së) si dhe përfaqësuesve të policive kufitare të

dy vendeve, filloi inspektimi i përbashkët nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe SHÇBA-së të Shqipërisë.

Ky inspektim i përbashkët erdhi pas nënshkrimit të protokollit për inspektim të përbashkët dhe si vazhdimësi e aktiviteteve në kuadër të Memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunim në fushën e kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjes policore, të nënshkruar nga Ministrat e Brendshëm të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në marsin e vitit të kaluar.

Dy ekiye të përbashkëta inspektimi me nga tre zyrtarë të agjencive mbikëqyrëse që ishin caktuar në bazë të protokollit të nënshkruar për disa ditë me radhë inspektuan dhe vlerësuan efikasitetin e patrullimeve të përbashkëta të Policisë së Kosovës dhe të Shqipërisë përgjatë vijës kufitare Kosovë-Shqipëri.

Qëllimi i këtij inspektimi ishte vlerësimi,





SHÇBA BASHKËT



**Inspektorati
Policor i Kosovës
(IPK) dhe Shërbimi
për Çështje të
Brendshme dhe
Ankesa (SHÇBA)
inspektuan policitë
kufitare të Kosovës
dhe Shqipërisë**

dhe respektimi i detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshjet dhe protokollet në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin policor ndërkufitar dhe patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit Shtetëror të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së personelit policor të dy vendeve, IPK dhe SHÇBA dhanë disa rekomandime si:

- Rekomandimi i niveleve qendrore dhe rajonale që sa më parë të angazhohen në drejtim të përpilimit të raporteve/analizat e vlerësimit të veprimtarisë së patrullave të përbashkëta me qëllim respektimin e rregullit të përcaktuar në protokoll për patrullime të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Kosovës

dhe Republikës së Shqipërisë.

- Rekomandimi që përgjegjësit e të dy drejtorive rajonale policore të Kosovës-Shqipërisë që gjatë hartimit të orarit (grafikut) të patrullimeve të përbashkëta të planifikojnë numër më të madh të patrullimeve në mënyrë që realizimi i tyre të arrijë numrin 240 për vit dhe në këtë mënyrë të përfilllet rregulli për të cilin janë pajtuar palët me marrëveshje teknike të mirëkuptimit.

- Rekomandimi që udhëheqësit e të dy drejtorive rajonale policore kufitare të angazhohen në gjetjen e modaliteteve, veprimeve përmes së cilave do të rritet efektiviteti dhe efikasiteti sa i përket masës represive-goditjes së krimit ndërkufitar si rezultat i patrullimeve të përbashkëta etj.



RAPORTO NË | PA

080003333 | PAGESË

Inspektorati Policor
i Kosovës